

Rregullore per Trajtimin e Mallrave gjate Transportit  
Hekurudhor dhe ne Sheshe e Magazina Tranzite

1988

Nr. 12

## R e g u l l o r e

Nr.12 Date 17.09.1988

### **Trajtimin e mallrave gjate transportit hekurudhor dhe ne sheshe e magazina tranzite**

Me qellim qe te forcohet ndjenja e pergjegjeshmerise dhe disiplina nga derguesit dhe pritesit e mallit dhe hekurudhes per administrimin e mbrojtjen e pasurise socialiste, ne zbatim te nenit 37te Kodit Hekurudhor, Ministria e Transporteve dhe infrastruktures nxjerr kete rregullore.

#### Kreu i Pare

#### Pranimi i mallrave per tu transportuar me hekurudhe

##### Neni 1

Te gjithë mallrat qe meren ne dorezim nga derguesi direkt ne degezimet hekurudhore ose vijne nga transportues te tjere per tu transportuar ne hekurudhe duhet detyrimisht te jene te shoqeruar me dokumentet perkatese ( flete ngarkese ). Nuk lejohet pranimi dhe shkarkimi i mallrave pa keto dokumente.

##### Neni 2

Mallrat qe pranohen per transport te metejshe hekurudhor duhet te jene te ambalazhuar ne baze te standartevedhe kushteve teknike te miratuara nga organet kompetente te cilat behen te njohura nga derguesi i mallit. Punonjesit e hekurudhes te caktuar me pranimin e mallrave duhet te njohin mire keto standarte. Kur verehet se mallrat nuk jane ne ambalazhe te tilla nuk pranohen dhe nuk meren ne dorezim.

Ne ambalazhin e mallit duhet te kete.

- Etiketimin e kolise ne menyre te qendrueshme dhe te pandryshueshme gjate transportit. Ne etikete duhet te jete i pershkruar lloji i mallit, permbajtjen e kolise, prodhuesin, perdoruesin dhe daten e prodhimit. Nuk meren ne dorezim mallrat qe nuk jane te etiketuar ne rregull osse qe kane 2 etiketa.
- Ne kolite e mallrave duhet te jete shenuar qarte shenjat konvencionale qe tregojne ruajtjen e mallit, menytrat e perpunimit ose kapjes se kolise, menyren e vendosjes gjate transportit etj.

### Neni 3

Mallrat e percaktuara ose tej kontrates pranohen vetem mbasi te jete bere kontrolli i tyre per pershtateshmerine e ambalazhit dhe pasi te jene caktuar pastruar e rregulluar vendi i depozitimit te tyre ne shesh ose magazine.

### Kreu i Dyte

#### Depozitimi i mallrave

### Neni 4

Stivimi i mallrave perfshin te gjithë veprimet qe kryhen per depozitimin e transportimin e ngarkesave nga derguesi apo stacioni nises deri te pritesi apo stacioni nises deri te pritesi apo stacioni fundor. Stivimi duhet te siguroje.

- Parandalimin e cdo demtimi te mallrave dhe ambalazheve nga perpunimi ( shkarkim ngarkimi) dhe transportimi i tyre.

- Te krijoje kushte per shkarkimin ngarkimin ne nje kohe sa me te shkurter e pa vonesa, perdorimin me efektivitet te mekanizmave dhe mjeteve te shkarkim ngarkimit.
- Te arrije shfrytezimin sa me te plote te kapaciteteve depozituese te magazinave dhe shesheve.
- Te siguroje mundesite per verifikimin e gjendjes se mallrave dhe inventarizimit te tyre te shpejte.

## Neni 5

Per te arritur trajtim e stivim te rregullt te mallrave duhet te meren masa para pergatitore per depozitimin e transportimin e tyre.

- Depot dhe sheshet e vendosjes se mallrave duhet te jene gjithenje te pastruara, te thata, ajrosura, te sigurta, pa shenja ose te mallrave te depozituara me pare, te ndricuara mire. Magazinat e mbyllura kur ne te depozitohen mallra ushqimore e te ngreneshme, here pas here dizinfektohen sipas rregullave higjeno-sanitare, ne dysHEME shtrohen mushama ose plasmas per ruajtjen e mallrave.
- Behet ndarja e magazinave per depozitimin e grup-mallrave qe kane karakter te afert perdorimi, si mallra ushqimore, plehera kimike, cemento, kripe etj. Per mallrat e rrezikshme se ndezese, helmuese, gerryese, caktohen depo, sheshe e vagona te vecante ne perputhje me kerkesat specifike qe kane per ruajtjen e administrimin e tyre, sipas rregullave te vecanta.
- Behet ndarja e shesheve per grupe mallrash te peraferta se hekura, materiale ndertimi, qymye etj.

Keto masa meren nga derguesit, pritesit si dhe nga rajonet e stacionet hekurudhore, here pas here ne perputhje me rrjedhjen e planifikuar te mallrave dhe gjendjes se kapaciteteve te magazinave dhe shesheve qe kane.

## Neni 6

Stivimi i mallrave ne magazine behet ne stiva te vecanta per cdo dergese. Ato vendosen ne largesi nga muret dhe ndermjet tyre jo me pak se 60 cm. Ne magazine lihet rruge kalimi per punetoret, mekanizmat e shkarkim ngarkimit. Lartesia e stives lejohet siaps llojit e qendrueshmerise se ambalazhimit te mallit duke siguruar mos demtimin e mallit dhe ambalazhimit si dhe nga mundesia e perdorimit me efektivitet te mjeteve te shkarkim ngarkimit.

Ne depot ku vendosen mallra rifuzo si drithera etj, nuk lejohet mbeshtetja e mallrave ne muret.

## Neni 7

Vendosja e mallrave ne sheshe behete duke i vene ato ne largesi nga toka ( me tako ). Stivimi behet i vecante per cdo dergese dhe distance deri ne 80 cm te stives nga stiva. Lartesia e stives lejohet me mundesine e mjeteve dhe mekanizmave, te shkarkim ngarkimit, plotesimit te kerkesave te sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune si dhe mundesite e ruajtjes nga demtimet e mallrave dhe ambalazheve te tyre.

## Neni 8

Mallrat rifuzo depozitohen ne sheshe te betonizuara dhe te ndara sipas llojit e cilesise te ketyre mallrave. Si rregull nuk lejohet futja e mjeteve te transportit brenda sheshit, kur nuk mund te behet ndryshe me pare duhet te pastrohen e te lahen jashte sheshit dhe3 ne te gjitha rastet nuk lejohet qe mjetet te kalojne mbi keto mallra.

## Neni 9

Ne depot, sheshet, ne vende te pershtateshme e te dukshme vendosen mjete te mbrojtjes nga zjarri te cilat duhet te jene gjithnje ne gadishmeri te plote.

## Neni 10

Te gjithë mallrat ( cdo dergese, lloj e cilesi malli rifuso ) qe depozitohen ne magazinat dhe sheshet pajisen me etikete te vecante ne te cilat duhet te shenohen, emertimi i mallit, i ndermarjes derguese e pritese, data e hyrjes ne magazine dhe numeri rendor i rregjistrimit ku eshte bere hyrje, sasia e mallit ne koli dhe ton.

## Kreu i Trete

### Trajtimi i mallrave gjate transportit

## Neni 11

Stivimi i mallrave ne vagona duhet te siguroje :

- Shfrytezimin e kapacitetit transportues te vagonit qe me maksimumin e kubatures te tij te transportohet maksimumi i peshes.
- Plotesimi i kerkesave te sigurimit te levizjes se vagonit duke bere stivim te plote dhe brenda gabariteve dhe kapacitetit bartes, shprendarjen uniforme ngarkeses ne te gjithë platformen e vagonit dhe mbi akset e tij.
- Te siguroje vete ngarkesen nga demtimet gjate levizjes se vagonit (udhetimit) si lidhje, fiksime, vendosje takosh etj.
- Krijimin e mundesive per shfrytezimin me efektivitet te mjeteve te shkarkim ngarkimit.

## Neni 12

Ngarkimi i mallrave ne vagona behet:

- Pasi te jete konstatuar pershtateshmeria e vagonit dhe pastertia e tij.
- Ne vagon ngarkohen mallra per nje prites ose per nje stacion tranzit ku u sherbehet disa pritesve.
- Nuk lejohet ngarkimi ne nje vagon i mallrave qe demtojne cilesine fiziko-kimike te njeri tjetrit. Mallrat e rrezikshme si ndezes, plases, gerryese, helmues etj vendosen ne vagona te vecante ku u sigurohen kushtet specifike qe duhen per transportin e tyre.
- Vagonat me destinacion te vecante ngarkohen vetem me mallrat per te cilat jane caktuar. Ngarkimi i tyre me mallra te tjere behet kur lejohen nga Drejtoria e Pergjitheshme e Hekurudhave dhe pasi te jene te lare, pastruar per te siguruar mosdemtimin r mallit qe do te ngarkohet ne to.

## Neni 13

Gjate kohes se shkarkim ngarkimit si dhe udhetimit te vagonave te ngarkuar me mallra te rrezikshem ndalohe:

- Pirja e duhanit, perdorimi i flakeve dhe mjeteve elektrike qe japin shkendija.
- Qendrimi i perspnave te jashtem ne to e afersi te tyre.
- Afrimi i automjeteve e mjeteve terheqese hekurudhore me vagona mbrojtes.

## Neni 14

Mbas ngarkimit te vagonit behet ( ose kerkohet te behet nga derguesi kur eshte ne degezim ) mbyllje te tij ( dyer, dritare, cati, hambare etj ) plumbosja e vendosja e shenjave konvencionale mbi mallra qe vertetojne moscenimin e mallit gjate transportimit e njekohesisht plotesimin e dokumentave te ngarkeses duke shenuar ne te permbajtjen e shenjave o simboleve te plumbosjes. Mbas shkarkimit te vagonit kerkohet pastrimi i vagonit dhe mbyllja e tij duke i konsideruar pjese perberese te procesimit te shkarkim ngarkimit.

## Kreu i Katert

### Dergimi ne kohe i mallrave tek pritesi (evadimi) eshte trajtimi me i mire i tyre

## Neni 15

Stacioni hekurudhor zbaton rradhen e evadimit te mallrave duke nisur nga koha e hyrjes se tyre ne stacion. Ne te gjithë rastet nisen mallrat (pavaresisht se cfare jane) qe kane hyre me pare.

Bejne perjashtim dhe mund te lejohet nisja e mallrave jashte rradhes ne keto raste.

- Per mallrat me sasi te vogla
- Per mallrat me gjatesi te medha, makineri etj, qe kerkojne mjete te specializuara.
- Per mallrat qe nga natyra e tyre demtohen ose shpredorohen shpejt ne kushtet e depozitimit te tyre ne sheshe te hapura.
- Per mallrat ushqimore e te konsumit te gjere qe dergohen me mjete te vecanta ( te mbyllura etj )

## Kreu i Peste

### Dispozita te Pergjitheshme

#### Neni 16

Shkelja e dispozitave te kesaj rregullorje kur nuk formom veper penale denohet si kundravajtje administrative sipas dispozitave te parashikuara ne Kodin Hekurudhor ( nenet 40/b, 42, 43 )

#### Neni 17

Rregulla te hollesishme per stivimin, trajtimin e transportin e mallrave te vecante e ngarkesave speciale nga stacionet e rajonet hekurudhore, ne zbatim te kesaj rregulloreje caktohen nga Drejtoria e Pergjitheshme e Hekurudhave.

#### Neni 18

Per transportin e mallrave me konteniere pervec rregullave qe percaktohen me siper zbatohen dhe ato te percaktuara ne rregulloren e vecvante per transportin e mallrave dhe perdorimit te konteniereve.

#### Neni 19

Aktet e leshuara nga Ministria e Transporteve, Drejtoria e Pergjitheshme e Hekurudhave si dhe cdo dispozite qe bie ne kundersizim me kete rregullore, shfuqizohen.

Kjo rregullore hyn ne fuqi me 01.10.1988

**M I N I S T R I**

**Luan BABAMETO**